



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit:22.1.1-2013-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË MITROVICËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013

Prishtinë, Qershor 2014

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa mund të ndërmerren edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t'i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Mitrovicës në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit Florim Beqiri i mbështetur nga Lavdim Maxhuni (Udhëheqës Ekipi) Mexhit Ferati dhe Shpresa Zenelaj.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia.....	7
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak	14
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	15
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZAP	39
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	42

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2013 i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Kryetarin e Komunës dhe ekipin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2013 u ndërmor në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorit Publik. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me PVF. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 14.11.2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse për Pasqyrave Vjetore Financiare të theksuara në Memon e Planifikimit të Auditimit;
- Reagimin ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Komunës së Mitrovicës (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ana e Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare në të gjitha aspektet materiale *prezantojnë një pamje të drejt dhe të plotë*, me përjashtim të çështjeve në vijim:

Në Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave nga palët e treta, komuna ka prezantuar vlerën 15,037,218€. Në totalin e këtyre pagesave është përfshirë edhe shuma e investimeve të bëra nga donatorët prej 8,700,218€ në "Kompaninë Rajonale të Ujësjesit" në Mitrovicë. Kjo kompani menaxhohet nga niveli qendror e jo nga komuna;

Në Pasqyrën e realizimit të buxhetit, shuma e donacioneve sipas buxhetit fillestar është prezantuar në vlerë 79,000€, ndërsa sipas tabelës së buxhetit të miratuar nga kuvendi, buxheti fillestar për donacione është 0.

Në Pasqyrën e realizimit të buxhetit, hyrjet e parasë së gatshme sipas buxhetit final komuna ka prezantuar donacionet më pak për 70,916€; dhe

Në Pasqyrën e realizimit të buxhetit, dalja e parasë së gatshme sipas buxhetit final komuna ka prezantuar buxhetin 70,000€ më pak se sa duhej.

Theksimi i çështjes

Gjithashtu, dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se Komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar vlerën prej 134,888€ për mallra dhe shërbime dhe vlerën prej 86,642€ për subvencione dhe transfere. **(SNISA 200: Opinion i Kualifikuar me Theksim të Çështjes).**

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Menaxhmenti i Komunës kishte dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm. Megjithatë, këto kontrolle nuk kishin funksionuar në disa fusha të rëndësishme të menaxhimit financiar. Këto duhet në vazhdimësi të monitorohen për t'u siguruar se janë duke funksionuar siç duhet. Ne në vazhdim po i paraqesim fushat në të cilat janë vërejtur mangësi:

- Pasqyrat Vjetore Financiare e paraqitura për auditim kishin një numër lëshimesh dhe pasaktësish. Disa janë ndryshuar në versionin final të Pasqyrat Vjetore Financiare, por menaxhmenti zgjodhi ti linte disa zëra të pakorrigjuara;
- Rekomandimet e vitit 2012 dhe të viteve të mëparshme nuk janë implementuar ende. Kjo do të rezultojë në kontrolle të dobëta/vlerë të dobët për para/humbje potenciale financiare të vazhdueshme;
- Menaxhmenti nuk kishte trajtuar mjaftueshëm adresimin e rekomandimeve të dhëna nga Njësisë së Auditimit të Brendshëm; dhe
- Edhe pse ne arritëm të merrnim siguri nga kontrollet efektive të menaxhmentit në disa fusha të pasqyrave, vlerësimi ynë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ka nxjerr në pah se në disa fusha të rëndësishme të veprimtarisë ekzistojnë dobësi domethënëse. Kjo veçanërisht ka ndodhur në prokurim, ku kontratat janë menaxhuar dobët, pastaj menaxhimi i dobët i të hyrave nga dhënia me qira e lokaleve, pronës dhe banesave, si dhe mos zbatimi i rregullores për subvencione.

Rekomandimet tona kryesore janë si në vijim:

- Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që në procesin e hartimit të Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2014 të përfshihet formalisht edhe rishikimi nga menaxhmenti i draft pasqyrave me fokus të veçantë në fushat që konsiderohen me rrezik të lartë për gabime dhe/ose fushat ku gabimet janë identifikuar në vitet e mëparshme;
- Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme;
- Kryetari i Komunës duhet bëjë një analizë tek lokalet, pronat, banesat e dhëna me qira duke i rishikuar të gjitha kontratat ekzistuese të qiramarrësve, me fokus të veçantë ngritjen e shkallës së inkasimit nga këto kategori;
- Kryetari i Komunës duhet të kryejë një vlerësim të detajuar të procesit të Prokurimit dhe kontrollit për të kuptuar se pse dobësitë vazhdojnë të shfaqen dhe të identifikojë veprimet që duhen zbatuar për t'i adresuar këto dobësi;
- Kryetari i Komunës duhet të shqyrtoj me një vëmendje të shtuar adresimin e të gjitha rekomandimeve të Njësisë së Auditimit të Brendshëm për të përmirësuar sistemin e kontrollit të brendshëm;
- Kryetari i Komunës duhet të siguroj se shfrytëzimi i mjeteve nga kategoria e subvencioneve të bëhet duke e respektuar rregulloren e brendshme për subvencione dhe mjetet nga kjo kategori të jepen në mënyrë sa më transparente duke raportuar për mënyrën se si po shfrytëzohen subvencionet; dhe
- Kryetari i Komunës duhet të formojë një komision profesional për të regjistruar të gjitha pasuritë që janë në pronësi të komunës (pronat, lokalet, banesat), si dhe të azhurnohen regjistrat e pasurive në vazhdimësi.

Përgjigja nga Menaxhmenti – auditimi për 2013

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha gjetjet e auditimit dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Menaxhmentit të përgatis PVF sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për "Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar shkallën deri në të cilën mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale gjatë përcaktimit të testimit të hollësishëm, të cilat janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) dhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i Kualifikuar me Theksim të Çështjes

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë një pamje të drejt dhe të plotë, me përjashtim të çështjeve në vijim:

Në Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave nga palët e treta, komuna ka prezantuar vlerën 15,037,218€. Në totalin e këtyre pagesave është përfshirë edhe shuma e investimeve të bëra nga donatorët prej 8,700,218€ në “Kompaninë Rajonale të Ujësjesit” në Mitrovicë. Kjo kompani menaxhohet nga niveli qendror e jo nga komuna;

Në Pasqyrën e realizimit të buxhetit, shuma e donacioneve sipas buxhetit fillestar është prezantuar në vlerë 79,000€, ndërsa sipas tabelës së buxhetit të miratuar nga kuvendi, buxheti fillestar për donacione është 0;

Në Pasqyrën e realizimit të buxhetit, hyrjet e parasë së gatshme sipas buxhetit final komuna ka prezantuar donacionet më pak për 70,916€; dhe

Në Pasqyrën e realizimit të buxhetit, dalja e parasë së gatshme sipas buxhetit final komuna ka prezantuar buxhetin 70,000€ më pak se sa duhej.

Theksimi i çështjes

Gjithashtu, dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se Komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar vlerën prej 134,888€ për mallra dhe shërbime dhe vlerën prej 86,642€ për subvencione dhe transfere.

(SNISA 200: Opinion i Kualifikuar me Theksim të Çështjes).

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 14.11.2013, janë identifikuar dy rreziqe domethënëse: atë për regjistrimin e të gjitha pasurive që kanë ndikim në PVF-të dhe shpалosjen e pagesave nga palët e treta.

Këto janë rreziqe të anomalive materiale, nga të cilat mund të rezultojë një opinion i modifikuar, përfshirë Theksimin e Çështjes.

Rreziku i anomalive materiale që ne kemi identifikuar në lidhje me regjistrimin dhe prezantimin e pasurive, identifikimin e pagesave nga palët e treta dhe prezantimin e tyre në PVF-të ka ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë veprime për të adresuar rreziqet e paraqitura.

Rreziku i identifikuar

Çështja 1. Mungesa e dëshmive për pagesat nga palët e treta që janë prezantuar në PVF.

E gjetura

Ne gjatë auditimit kemi vërejtur se komuna nuk kishte arritur të identifikoj saktë pagesat e kryera nga palët e treta dhe në këtë mënyrë prezantimi prej 15,037,218€ që është bërë në PVF nuk është i saktë dhe i plotë. Në totalin e këtyre pagesave përfshihen edhe pagesat (përfitime) që nuk janë nën menaxhim të komunës, si investimet e bëra në “Kompaninë Rajonale të Ujësjetës” në Mitrovicë në vlerë prej 8,700,218€. Kjo kompani menaxhohet nga niveli qendror e jo nga komuna. Po ashtu e vlera e prezantuar në PVF nuk është mbështet me dëshmi për ta treguar saktësinë dhe plotësinë e tyre.

Rekomandimi 1 Prioriteti i lartë-Kryetarin i Komunës të siguroj se do të identifikohen të gjitha pagesat nga palët e treta që janë bërë në Komunën e Mitrovicës dhe këto të mbështeten me dokumentet burimore në mënyrë që të prezantohen drejt në PVF-të.

Rreziku i identifikuar

Çështja 2. Mungesa e regjistrimit të pasurive që janë në pronësi

Pasuritë në pronësi të Komunës si lokalet, banesat dhe pronat nuk janë identifikuar dhe regjistruar në regjistrat e pasurive, duke rezultuar kështu me anomali materiale në shënimet e pasurive në PVF.

E gjetura

Ne i kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për ta dëshmuar se a janë regjistruar të gjitha pasuritë që janë në pronësi të komunës në regjistrat e pasurive. Në memon e auditimit të ndërmjetëm, ne i kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimin që nevojitet për të siguruar që shifra e pasurive në PVF të jetë e saktë. Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar sepse Menaxhmenti nuk ka arritur të aplikojë përmirësimet e nevojshme në kontrollin e brendshëm dhe ne kemi konfirmuar që vlerat e pasurive të regjistruara në PVF janë materialisht të pasakta. Kjo sigurisht do të ketë refleksione në dhënien e opinionit të auditimit.

Rekomandimi 2 Prioritet i lartë -Kryetari duhet të identifikojë veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurive në vitin 2014.

2.3 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

Përshkrimi

PVF-të duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare (RrF) nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- PVF janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave (MoF);
- PVF janë nënshkruar nga ZKA (Kryetari i Komunës) dhe ZKF;
- PVF janë pranuar në gjuhën shqipe dhe serbe;
- PVF janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike; dhe
- Komuna kishte përgatitur dhe dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Kuvendi Komunal dhe një kopje tek Ministri i MF gjatë vitit 2013.

PVF-të fillestare kanë përmbajtur disa gabime. Gjatë procesit të auditimit, komunës i është dhënë mundësia e korrigjimit, mirëpo edhe pas korrigjimit PVF-të përmbajnë gabime në saktësinë dhe plotësinë e tyre që po i paraqesim me poshtë:

Çështja 3. Procesi i përgatitjes së Pasqyrave - Prioriteti - i lartë

- E gjetura** Te neni 12 Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme tek shtylla pagesat nga palët e treta komuna nuk ka prezantuar drejt vlerën 15,037,218€. Për më shumë referoju kapitullit 2.2 të këtij raporti.
- Te neni 13 Pasqyra e realizimit të buxhetit te shënimi 16 donacionet shtylla e buxhetit fillestar komuna ka prezantuar shumën e ndarë në vlerë 79,000€, ndërsa sipas tabelës së buxhetit të nxjerr nga kuvendi, buxheti fillestar për donacione është 0.
- Në nenin 13 Pasqyra e realizimit të buxhetit hyrja e parasë së gatshme, te shënimi 16 shtylla e buxhetit final komuna ka prezantuar donacionet më pak për 70,916€.
- Në nenin 13 Pasqyra e realizimit të buxhetit dalja e parasë së gatshme te shtylla e buxhetit final komuna ka prezantuar 70,000€ buxhet më të vogël se sa duhej.
- Të shënimi 30 Përmbledhje e pasurive jo financiare kapitale pasuria e paraqitur me vlerë mbi 1,000€, në PVF ishin nënvlerësuar për 25,580€.
- Komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar për mallra dhe shërbime vlerën prej 134,888€, dhe për subvencione dhe transfere vlerën prej 86,642€.
- Rreziku** Paraqitja jo e saktë e PVF dhe gabimeve të identifikuar në shumat e regjistruara shpie në një keqkuptim të pozitës financiare të komunës dhe ka ndikim potencial negativ në saktësinë e kërkesave të ardhshme buxhetore.
- Rekomandimi 3** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani për hartimin e PVF të vitit 2014 të adresojë formalisht të gjitha kërkesat e që kanë të bëjnë me cilësinë e informatave. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet me pohime të tilla, përveç nëse në të gjitha draft PVF janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

2.4 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

Përshkrim

Përveç hartimit të PVF-ve, nga Komuna kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesa Buxhetore për financimin e projekteve kapitale në Ministrinë e Financave;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Raporti i vetëvlerësimit sipas rregullave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK);
- Draft Plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë; dhe
- Raportet mbi borxhet e dorëzuara në MF.

Ne nuk kemi çështje për të ngritur në lidhje me këto pasi që komuna i ka përmbushur të gjitha obligimet për raportim të jashtëm. Po ashtu, plotësimi i kërkesave ka qenë i cilësisë së mirë dhe në pajtim me afatet kohore që janë kërkuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti i komunës nuk kishte trajtuar rekomandimet e dhëna në vitin e kaluar me kujdesin e duhur, dhe kjo ka shkaktuar që disa nga rekomandimet e njëjta, të përsëriten edhe këtë vit, për të siguruar se dobësitë dhe mangësitë e identifikuara janë korrigjuar.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2012 kishte rezultuar në 20 rekomandime. Menaxhmenti i komunës ka përgatitur një Plan Veprimi me zotimin se të gjitha rekomandimet do të adresohen.

Në fund të auditimit ne kemi vërejtur se pesë rekomandime ishin adresuar plotësisht; katër pjesërisht apo janë në proces të adresimit, dhe 11 nuk ishin adresuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II në fund të këtij raporti.

Çështja 4. Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar ishin adresuar, sepse Menaxhmenti nuk ka zbatuar ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të brendshme në sistemet financiare kyçe, si Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë rezultuar në:

- Menaxhim jo të mirë tek subvencionet duke mos e arritur qëllim e dhënë;
- Mungesë e masave dhe mekanizmave adekuat për maksimizimin e mbledhjes së të hyrave (mbledhja e të hyrave ishte në një shkallë mjaft të ultë);
- Jo efikasiteti i vazhdueshëm organizativ dhe vlera e dobët për para në praktikën e prokurimit;

Rekomandimi 4 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv dhe rezultateve nga këto veprime. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, mirëpo nuk po zbatohen në praktikë dhe nuk po funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, duke përfshirë rolin e ndërmarrë nga Auditimi i Brendshëm dhe Komitetet e Auditimit.

Ne gjithashtu kemi marrë në konsideratë vetë-vlerësimin e Komunës të ndërmarrë në kuadër të Menaxhimit të Financave Publike (MFP) në lidhje me vetë-vlerësimin e Kontrolleve të Brendshme të Financave Publike (KBFP).

Ne kemi gjetur se kontrollet mbi të hyrat nuk po zbatohen në mënyrë efektive. Kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojë që komuna të ketë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv të projektit. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë: Prokurimi, Të hyrat, Subvencionet, dhe Menaxhimi i pasurisë.

4.2 Qeverisja e mirë

Përshkrim

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

Çështja 5. Dobësi në kontrollet e menaxhmentit të lartë

E gjetura Rishikimi që ne i kemi bërë kontrollove menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar kryesor të komunës ka nxjerrë në pah një raportim të dobët mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë. Kjo ka ndodhur për shkak se nuk ka pasur raportime të rregullta me shkrim prej drejtorive përkatëse tek kryetari i komunës mbi punët dhe aktivitetet e drejtorateve. Ne nuk jemi mbështetur në funksionimin e kontrolleve të nivelit të lartë tek shumica e kategorive ekonomike.

Rreziku Cilësia e dobët e raportimit financiar tek menaxhmenti i lartë redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar në mënyrë aktive aktivitetet e komunës dhe dëmton kontrollin efektiv buxhetor. Kjo mund të rezultojë në deficit ose suficit të paplanifikuar dhe të vonojë veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato. Kjo mund të ndikoj në ruajtjen e ekuilibrit buxhetor.

Rekomandimi 5 Kryetari i Komunës duhet të kryejë një rishikim të formës së raportimit tek menaxhmenti i lartë, për të përcaktuar çka kërkohet për të mbështetur menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të paraqesë një zgjidhje të përshtatshme deri më 1 shtator 2014.

4.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Në kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për Komunën e Mitrovicës shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – shpenzimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	15,108,605	17,770,924	16,398,203	17,718,664	17,793,939
Granti i Qeverisë -Buxheti	12,906,285	14,825,832	14,654,588	15,491,288	16,048,928
Të bartura nga viti paraprak ² -	-	236,856	235,901	443,509	421,005
Të hyrat vetanake ³	2,202,320	2,202,320	1,239,425	1,387,880	1,194,752
Donacionet e brendshme	-	326,395	163,331	127,368	39,479
Donacionet e jashtme	-	179,521	104,958	268,619	89,775

Buxheti final, krahasuar me buxhetin fillestar, është më i lartë për 2,662,319€. Kjo rritje është rezultat i vendimeve të qeverisë për projektet kapitale, donacioneve vendore dhe të jashtme dhe të hyrave të bartura nga viti paraprak.

Në vitin 2013 Komuna ka shpenzuar 92% të buxhet final, ndërsa vitin 2012 buxheti është shpenzuar 93%. Në përgjithësi, kjo mund të konsiderohet një performancë e mirë e ekzekutimit buxhetor.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Të hyrat komunale të planifikuara dhe të mbledhura në vitin aktual që është përdorur nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	15,108,605	17,770,924	16,398,203	17,718,664	17,793,939
Pagat dhe Mëditjet	8,723,913	8,896,091	8,842,940	9,792,508	10,322,719
Mallrat dhe Shërbimet	1,450,230	1,488,085	1,380,404	1,545,347	1,640,763
Shërbimet komunale	422,222	428,372	425,406	433,447	443,003
Subvencionet dhe Transferet	679,880	875,880	787,854	773,744	522,558
Investimet Kapitale	3,832,360	6,082,496	4,961,599	5,173,618	4,864,896

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Pavarësisht rritjes në buxhetin për shpenzime kapitale gjatë vitit, vetëm 81% e buxhetit ishte shpenzuar. Programi për Investime Publike përfshin disa projekte në vazhdim nga viti i kaluar dhe projekte të reja për vitin aktual. Arsyeja e mos shpenzimit në nivel të kënaqshëm për këtë kategori ka ardhur si rezultat i mos përfundimit të punëve në terren nga operatorët ekonomik për projektet që kishin filluar;
- Rritja e buxhetit për kategorinë e Subvencioneve kishte ndodhur me kërkesën që kishte bërë komuna në Qeveri për pagesën e qirasë për familjet e pjesës veriore të qytetit;
- Buxheti fillestar në raport me buxhetin final për Shërbimet komunale dhe Mallrat dhe shërbimet nuk kishte ndryshim;
- Komuna ka pranuar gjithashtu grande nga donatorët vendorë në vlerën 326,394€, ndërsa prej tyre janë shpenzuar 163,331€ për kategorinë e Investimeve Kapitale për projektet e ndërtimit të rrugëve.
- Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar ka patur rritje në kategorinë e pagave dhe mëditjeve në vlerë 172,178€. Ky ndryshim ka ndodhur me rastin e bartjes së të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2012 në vitin 2013 në vlerë prej 163,513€ si dhe nga një donacion i jashtëm nga "Save the Children" në vlerë prej 8,665€.

Asnjë vit të hyrat vetanake nuk shpenzohen në tërësi, si rezultat direkt i mos ekzekutimit të buxhetit, duke pasur parasysh se të hyrat vetanake janë burimi i fundit financiar i përdorur. Në vitin 2014 vlera e bartur e të hyrave ka qenë mbi 130,000€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake komunale të buxhetuara dhe të mbledhura në 2013 (në euro)

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	2013 Pranimi	2012 Pranimi	2011 Pranimi
Të hyrat vetanake	2,202,320	2,202,320	1,368,877	1,700,028	1,650,134

Buxheti fillestar për të hyrat vetanake nuk pasqyronte pranimet e vitit të kaluar dhe faktorët e tjerë relevant. Nga tabela shihet se realizimi i të hyrave ishte 62%. Në krahasim me vitin paraprak, të hyrat e realizuara ishin për 24% më të ulëta, po ashtu në raport me vitin 2011 për 21% më të ulëta.

Rënie më e theksuar është shënuar tek drejtorati i urbanizimit, ku të hyrat e planifikuara për vitin 2013 kanë qenë 1,044,000€, ndërsa realizimi është 291,823€, apo 28% dhe te drejtoria e zhvillimit ekonomik ku ishte planifikuar të realizohet shuma prej 118,360€, ndërsa ishin mbledhur vetëm 19,948€ apo 17%. Variancat në mes shumave të planifikuara dhe të realizuara në këto dy Drejtori janë të mëdha dhe determinojnë një efikasitet të ultë.

Në anën tjetër, listat e debitorëve ndaj komunës kanë kaluar shifrën prej 9.7 milionë, që paraqet një shumë domethënëse. Gjendja e llogarive të arkëtueshme është në rritje të vazhdueshme.

Çështja 6. Ekzekutimi i buxhetit - Prioriteti i Lartë

E gjetura Ekzekutimi i buxhetit në nivel të përgjithshëm ishte në nivel të kënaqshëm, përveç te kategoria e investimeve kapitale që kishte një realizim të ulët rreth 81%. Arsyeja e kësaj përqindjeje është ngecja në realizimin e projekteve kapitale në krahasim me dinamikën e planifikuar.

Rreziku Planifikimi jo i duhur dhe ekzekutimi i ulët i buxhetit te kategoria e investimeve kapitale mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxheti i vitit 2014.

Rekomandimi 6 Kryetari i Komunës duhet të monitorojë në mënyrë sistematike performancën buxhetore, sidomos te kategoria e investimeve kapitale dhe të identifikojë dhe adresojë barrierat për të planifikuar nivelet e ekzekutimit të buxhetit. Nëse supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.

4.4 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

Përshkrimi

Të hyrat e gjeneruara nga Komuna e Mitrovicës në vitin 2013 ishin në total 1,368,877€. Zërat kryesor që përbëjnë shumat e mbledhura janë: Të hyrat nga tatimi në pronë; Të hyrat nga lejet e ndërtimit; Taksat administrative, etj.

Çështja 7. Tatimi në pronë - Prioritet i lartë

- E gjetura** Duke u mbështetur në të dhënat e ofruara nga softueri i tatimit në pronë komuna për vitin 2013 kishte faturuar 17,826 obligues me vlerë prej 906,530€, ndërsa ka arritur të inkasoj shumën 450,485€ apo gjysmën e shumës së faturuar.. Ne kemi marrë për testim 18 mostra (kartela financiare) me vlerë 108,338€. Prej tyre rezultojë se vlera e papaguar ishte 43,385€. Shuma totale e borxheve të pa inkasuara ishte 4,313,000€. Komuna nuk kishte hartuar ndonjë strategji me mekanizmat dhe veprimet e duhura se si të mblidhen këto borxhe. Kjo saldo nga viti paraprak ishte rritur për 774,000€, çka donë të thotë se borxhet e pa mbledhura po shënojnë një rritje domethënëse nga viti në vit.
- Rreziku** Mos realizimi i të hyrave dhe rritja e borxheve prej viti në vit nga tatimi në pronë ndikon që të hyrat e komunës të zvogëlohen dhe redukton mundësinë e realizimit të shumë projekteve potenciale me vetëfinancim.
- Rekomandimi 7** Kryetari i Komunës duhet të rishikoj politikat aktuale dhe të ndërrmarë masat dhe veprimet konkrete për mbledhjen e këtyre borxheve, duke mos përjashtuar edhe masat administrative dhe gjyqësore.

Çështja 8. Lejet e ndërtimit - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna gjatë vitit 2013 kishte planifikuar të realizoj shumën prej 849,000€ nga lejet e ndërtimit ndërsa kishte inkasuar vlerën prej 191,056€ apo 22%.

Duke u bazuar në raportin e inspektoratit gjatë vitit 2013 janë marrë 27 aktvendime për rrënimin e objekteve që kanë të bëjnë me ndërtime pa leje, pastaj tejkalime në paramasa vertikale dhe horizontale. Prej tyre 12 janë rrënuar nga komuna që kanë qenë kryesisht kiosqe të vogla, ndërsa për 15 prej tyre që kanë qenë të përfshira në kategorinë e objekteve të larta, drejtoria e inspeksionit nuk kishte ndërmarr asgjë për t'i rrënuar ato si ndërtime të pa lejuara.

Rreziku Ndërtimi i objekteve pa leje dhe mos ndërmarrja e masave nga komuna për t'i rrënuar këto objekte ndikon që të hyrat e komunës të zvogëlohen. Kjo, po ashtu, ndikon në degradimin e hapësirës publike.

Rekomandimi 8 Kryetari i Komunës duhet që të siguroj se do merren masa që mos të ketë ndërtime pa leje dhe pasi që të nxirren vendimet për rrënimin e objekteve, të njëjtat të ekzekutohen deri në finalizim nga organet përkatëse.

Çështja 9. Të hyrat nga pronat e dhëna me qira - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna nga të hyrat për tokën, lokalet dhe banesat e dhëna me qira kishte planifikuar që të realizoj 80,000€, ndërsa kishte realizuar 47,691€. Ne kemi testuar 30 mostra, ku i kemi identifikuar këto parregullsi:

Në tri raste kemi identifikuar që komuna kishte lidhur kontratë për dhënien me qira të tokës ndërtimore në vitin 2009 dhe 2011, ndërsa qiramarrësit nuk kishin kryer obligimet kontraktuese. Ata nuk kishin paguar asnjëherë ndaj komunës dhe borxhi i tyre ka arritur vlerën prej 16,809€. Komuna nuk kishte ndërmarrë ndonjë masë për t'i obliguar këta shfrytëzues që të përmbushin obligimet e tyre.

Në dy raste komuna kishte lidhur kontratë për dhënien me qira të lokaleve me persona fizik; njëri në vitin 2010, dhe tjetri në vitin 2011 ku qiraja mujore është 203€ për rastin e parë dhe 73€ për rastin e dytë. Këta nuk kanë paguar asnjëherë ndaj komunës dhe qiramarrësit vazhdojnë t'i shfrytëzojnë lokalet edhe me tutje.

Drejtoria e urbanizmit në vitin 2011 kishte lidhur kontratë me shfrytëzuesin "NSH. Klinika Dentare Shkodrani" për dhënien me qira mujore të dy lokaleve afariste në vlerë prej 289€. Në kontratë është cekur se lokali do të meremetohet nga shfrytëzuesi dhe qiramarrësi kishte sjellë një plan ideor se në këto lokale do investoj rreth 19,489€. Komuna nuk kishte formuar ndonjë komision për ta pranuar investimin e bërë dhe nuk dihet se sa është investuar në këto lokale nga qiramarrësi. Po ashtu, shfrytëzuesi nuk kishte paguar asnjëherë ndaj komunës qiranë mujore.

Po ashtu, në dy raste është nënshkruar kontrata për dhënien në shfrytëzim të banesave dy personave fizik. Njëra kontratë është nënshkruar në vitin 2009 ndërsa tjetra në vitin 2010. Shfrytëzuesit obligohen sipas kontratës që për çdo muaj ta paguajnë qiranë në vlerë prej 18€ dhe 19€ ndërsa, këta shfrytëzues nuk kanë paguar asnjëherë obligimet e tyre.

Ne kemi identifikuar edhe 14 banesa që gjenden para komune ku komuna kishte lidhur kontrata me këta shfrytëzues ne vitin 2009 deri 2011. Qiraja mujore për këto banesa është rreth 18€ për një muaj, mirëpo këta shfrytëzues nuk kishin paguar qiranë ndërsa edhe me tutje vazhdojnë t'i shfrytëzojnë këto banesa. Komuna nuk kishte ndërmarr asgjë për t'i obliguar qiramarrësit që t'i kryejnë obligimet e tyre.

Rreziku Realizimi i ulët të hyrave nga kjo llogari është si rezultat i menaxhimit të dobët të kontratave nga menaxhmenti i komunës dhe kjo rritë rrezikun se nuk do realizohen të hyrat e planifikuara nga kjo fushë. Kontrollat ekzistuese mbi pronat e dhëna me qira janë shumë të dobëta dhe kjo ka rezultuar me një shkallë shumë të ultë të inkasimit.

Rekomandimi 9 Kryetari i Komunës duhet t'i rishikoj të gjitha kontratat ekzistuese për dhënien me qira të tokës, lokaleve dhe banesave dhe të identifikoj arsyet pse nuk po kryhen obligimet. Duhet të ndërmerren masa me kohë nga menaxhmenti që qiramarrësit t'i kryejnë obligimet në çdo muaj sipas kontratës.

Çështja 10. Taksat për veprimtari biznesore - Prioritet i mesëm

E gjetura Komuna ka inkasuar gjithsej 30,760€, nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë për vitin 2013 dhe në krahasim me 42,562€ të mbledhura në vitin 2012, kemi një shkallë rënëse të inkasimit. Në Komunë operojnë afro 2,666 biznese, ku shuma e ngarkuar për këtë kategori të të hyrave ishte 390,913€. Ne kemi testuar 11 mostra që kapin vlerën prej 38,733€, ku prej tyre kanë mbetur borxh shuma 36,575€, ndërsa borxhi i grumbulluar nëpër vite për këtë lloj të hyre është 5,139,311€.

Sipas zyrtarëve, inkasimi jo i mirë nga licencat e biznesit ka ardhur si rezultat i një numri të madh të bizneseve të cilët ngarkohen, ndërsa të njëjtat janë jo aktive. Softueri i shfrytëzuar nga komuna për këtë veprimtari nuk ofron raporte mbi gjendjen e bizneseve që janë aktive dhe në këtë mënyrë edhe ngarkesat që bëhen për biznese nuk janë të sakta për arsye se ka raste kur ngarkohen bizneset që janë jo aktive.

Rreziku Politikat e inaksimit duket të jenë të dobëta për të siguruar maksimizimin e të hyrave. Vonesat në mbledhjen e të hyrave sjellin dështimet në vendimmarrjen e menaxhmentit për financimin e projekteve të parashikuara. Po ashtu, shfrytëzimi i një shtabi jo funksional për këtë veprimtari ndikon që të mos ketë raporte të sakta mbi gjendjen e bizneseve.

Rekomandimi 10 Kryetari i Komunës duhet të siguroj se do merren masa për t'i mbledhur borxhet në mënyrë që të rritet inaksimi i të hyrave nga kjo kategori për financimin e projekteve të parashikuara. Po ashtu, të siguroj se do të instalohet një databazë e mirë në mënyrë që të ketë evidenca të sakta për bizneset që operojnë në këtë komunë.

4.5 Shpenzimet

4.5.1 Prokurimi

Përshkrimi

Komuna ndonëse ka të dizajnuara kontrolle formale mbi shpenzimet, ka rezultuar se ato nuk operojnë në mënyrën e duhur. Pagesat për disa artikuj jashtë specifikacionit teknik, ndarja e tenderëve për t'iu shmangur procedurave të hapura, shpërblimi i ofertuesve të papërgjegjshëm, pagesat për mallra që nuk janë pranuar nga përfituesit janë vetëm disa raste që përshkruajnë dështimin e kontrolleve.

Kontratat që kanë kaluar nëpërmjet procedurave të prokurimit për vitin 2013 ishin në vlerë prej 6,070,547€.

Ne kemi analizuar nëse projektet për investime kapitale kanë qenë të përfshira në PIP dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Gjithashtu, kemi rishikuar nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim në projektet e parapara për t'u realizuar gjatë vitit. Ne kemi vlerësuar se nuk është respektuar në përpikëri sistemi i PIP-it. Ka pasur raste të keq klasifikimit të shpenzimeve kur nga Investimet kapitale janë paguar subvencione dhe Mallra dhe Shërbime.

Ne kemi ekzaminuar 90 mostra (pagesa) që kapin vlerën prej 2,097,629€. Testet tona në kanë identifikuar çështjet në vijim:

Çështja 11. Klasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate - Prioritet i lartë

E gjetura Gjatë rishikimit të pagesave për investime kapitale ne kemi vërejtur se komuna kishte bërë klasifikimin e shpenzimeve në kode të gabuara:

- Ne 15 raste shpenzimet për pastrimin e lumenjve Trepça, Lushta dhe Sitnica, dhe pastrimin e rrugëve ishin klasifikuar me kod ekonomik 31900 si kapitale tjera, ndërsa këto shpenzime është dashur të regjistrohen dhe paguhen nga kategoria e mallrave dhe shërbime pasi që natyra e këtyre shpenzimeve nuk ka bërë me investime kapitale. Vlera e këtyre pagesave është 134,888€;
- Dy pagesa të dhëna si subvencion Bashkësisë Islame për shërbime të varrimit në vlerë prej 86,642€ ishin klasifikuar si shpenzime kapitale me kod ekonomik 31900;

Rreziku Regjistrimi i gabuar i shpenzimeve zvogëlon efektivitetin e mekanizmave të kontroleve buxhetore dhe mund të ndikojë në procesin e vendimmarrjes së menaxhmentit. Shpenzimet e tilla mund të rezultojnë në dështim të përmbushjes së objektivave të planifikuara. Gjithashtu, pagesa nga kode jo adekuate rritë rrezikun e keq pohimit të shpenzimeve në pasqyra financiare.

Rekomandimi 11 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të gjitha shpenzimet të bëhen sipas natyrës përkatëse në përputhje me kërkesat e LMFPP-së dhe Ligjit të Buxhetit.

Çështja 12. Mosrespektim i kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit – Prioritet i lartë

E gjetura Te kontrata “Botimet, Publikimet dhe Shtypja e Materialeve të ndryshme për institucionet e Komunës së Mitrovicës” me vlerë prej 30,000€, njëri nga kriteret e vendosura në dosjen e tenderit ishte që operatori ekonomik (OE) të ketë referenca për furnizimet e ngjashme. Ne kemi konstatuar se në dosjen e kompanisë fituese mungojnë këto referenca. Po ashtu, fituesi është përzgjedhur në mungesë të dy ofertuesve të përgjegjshëm sepse operatori i dytë nuk i kishte plotësuar të gjitha kriteret e vendosura me dosje të tenderit.

Te kontrata Furnizim me klima për Departamenti për Kulturë Rini dhe Sport (DKRS) me vlerë 6,450€, kriter në dosjen e tenderit ka qenë që operatori ekonomik ta ketë vërtetimin e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) brenda tremujorit të fundit për konfirmimin e pagesës së tatimeve. Ne kemi konstatuar se fituesi nuk e kishte ofruar këtë dokument.

Tek kontrata “Furnizim me material harxhues për zyrë në komunë dhe institucione tjera” kriter obligativ në dosjen e tenderit ishin që operatori të ketë listën e projekteve të realizuara për tri vitet e fundit, përfshirë edhe planin e furnizimit. Kompania fituese nuk i kishte sjell këto dokumente. Gjithashtu, kriter obligativ për fituesin ishte vërtetimi për tatimin në pronë, i cili po ashtu nuk ishte ofruar nga fituesi. Po ashtu, pagesa në vlerë prej 2,277€ për këtë kontratë ka mbuluar furnizimet jashtë kontratës bazë në shumën prej 1,235€ .

Rreziku Mos respektimi i kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit gjatë vlerësimit të ofertave rrit rrezikun e përzgjedhjes së ofertuesve të papërgjegjshëm.

Rekomandimi 12 Kryetari i Komunës duhet të siguroj se në të gjitha rastet e prokurimit, vlerësimi i ofertave bëhet në mënyrë objektive dhe të respektohen të gjitha kriteret e vendosura në dosjen e tenderit.

Çështja 13. Mungesa e raporteve me rastin e angazhimit të punëtorëve me kontrata për marrëveshjet e veçanta – Prioritet i lart

E gjetura Sipas ligjit për Shërbimin Civil kontratat mbi marrëveshjet e veçanta deri në 6 muaj organizata buxhetore mund t'i nënshkruajë për pune specifike (si ekspertë të fushave përkatëse) ndërsa komuna i kishte angazhuar tre punëtor me kontrata me marrëveshje për shërbime të veçanta për një periudhe 6 mujore për “mbikëqyrjen e projektit të tregut në Mitrovicë” të cilët i kishte paguar me vlerë prej 5,160€. Neve nuk na është ofruar ndonjë raport lidhur me atë se çfarë pune kanë kryer këta punëtor që janë angazhuar në këtë formë.

Kryetari i Komunës me datë 01.04.2013 kishte nënshkruar kontratë për shërbime të veçanta me një person për kryerjen e punëve si shofer i kryetarit. Sipas Ligjit për shërbyesit civil neni 12 pika 4 kontrata për shërbime të veçanta duhet të lidhet për një periudhë më të shkurt se 6 muaj. Kjo kontratë kishte skaduar me datë 30.09.2013 mirëpo ishte vazhduar edhe tre muaj tjerë.

Rreziku Mungesa e raporteve për punët e kryera nga punëtorët e angazhuar, dhe pagesa e punëtorit mbi gjashtë muaj rritë rrezikun të bëhen pagesa jo të rregullta.

Rekomandimi 13 Kryetari i Komunës duhet të siguroj se kontratat me marrëveshje të veçanta të përdoren për qëllimin e përcaktuar dhe se punëtorët e kontraktuar në këtë mënyrë raportojnë për punën e bërë.

Çështja 14. Ndarja e tenderëve për t'iu shmangur procedurave të hapura të prokurimit - Prioritet i lart

E gjetura Departamenti i prokurimit, për shërbime të ngjashme kishte aplikuar kuotim të çmimeve, me qëllim për t'iu shmangur procedurave të hapura të tenderimit. Kjo është vërejtur te kontratat "Furnizim me pajisje speciale mjekësore" ku njëra kontratë ishte 7,700€ ndërsa tjetra 4,295€. Buxheti për këtë projekt ishte 12,000€.

Rreziku Ndarja e tenderëve për t'iu shmangur procedurave të hapura të prokurimit paraqet rrezik potencial se do ketë shpenzime më të larta për mallrat apo shërbimet e blera dhe nuk ofron mundësi të barabartë konkurruese.

Rekomandimi 14 Kryetari i Komunës duhet të siguroj se gjatë kërkesave për furnizime, fillimisht të bëhet një planifikim i mirë sipas nevojave reale, në mënyrë që mos të ketë ndarje të tenderëve për t'iu shmangur procedurave të hapura të prokurimit.

Çështja 15. Pagesa për material ndërtimor - Prioritet i lartë

Komuna në vitin 2011 kishte lidhur kontratë për Furnizim me material ndërtimor për ndërtimin e shtëpive për raste sociale. Buxheti për këtë projekt në sistemin e PIP-it ishte planifikuar për ndërtimin e shtëpive në pjesën veriore të qytetit, por ka pasur raste kur përfitues kanë qenë edhe banoret e pjesës jugore të qytetit. Ekipi nga ZAP së bashku me organin mbikëqyrës të komunës kanë bërë ekzaminim fizik te katër (4) përfitues dhe kemi vërejtur se dy prej tyre kishin pranuar material më pak për 3,960€ se sa tregon fletëdërgesa, faturat dhe pagesa.

Rreziku Pagesa për materialin për ndërtim që nuk është pranuar nga ana e përfituesve rrit rrezikun që kjo pjesë të jetë manipuluar nga ana e zyrtarëve komunal apo operatorit furnizues.

Rekomandimi 15 Kryetari i Komunës duhet të inicioj këtë çështje tek organet mbikëqyrëse të projektit dhe të sigurohet se sasia e lejuar e materialeve ndërtimore ka arritur tek përfituesit e fundit. Në të kundërtën, duhet të pasojnë masat e llogaridhënies se çfarë ka ndodhur me sasi të e faturuara, por të pa dorëzuara tek përfituesit.

Çështja 16. Përfshirja e pozicionit të njëjt në dy kontrata të ndryshme- Prioritet i lartë

E gjetura Komuna kishte kontratë me OE "BURIMI" për rrënimin e objekteve pa leje. Po ashtu, kishte lidhur kontratë për "Ndërtimin e rrugës dhe urës Mbretëresha Teutë" me OE NN "EURO NDERTIMI" me vlerë të kontratës prej 137,443€. Brenda të dy projekteve ishte përfshirë rrënimi i 4 objekteve. Nga raporti i organit mbikëqyrës për ndërtimin e rrugës kemi konfirmuar se pozicioni i rrënimit të objekteve ekzistuese ishte kryer nga OE NN "EURO NDERTIMI". Mirëpo, të njëjtin pozicion e kishte faturuar edhe OE "BURIMI" që kishte kontratë për rrënimin e objekteve të ndërtuara pa leje. Operatori Burimi kishte faturuar pa të drejt këtë pozicion me vlerë prej 1,679€, dhe ju kishte bërë pagesa, ndërsa punën e kishte kryer operatori Euro Ndërtimi.

Rreziku Pagesa e pozicioneve të njëjta nga dy projektet dhe gabimit gjatë mbledhjes së totalit të faturës ka ndikuar që të dëmtohet buxheti i komunës.

Rekomandimi 16 Kryetari i Komunës duhet të siguroj se do të forcoj kontrollet me rastin e çertifikimit të pagesave, në mënyrë që mos të bëhen pagesa të parregullta/të dyfishta.

4.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Buxheti i planifikuar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 8,896,091€, ndërsa shpenzimet për këtë kategori ishin 8,842,940€ apo rreth 99%, ku mund të konkludojmë se buxheti i shpenzuar ishte shumë saktë i kalkuluar dhe i shfrytëzuar sipas parashikimeve.

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollet që operojnë në nivel lokal nga komuna, kanë të bëjnë me: a) kontrollin i pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listën e pagave b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Për këtë kategori testuam 60 mostra ku rishikuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e payrollit në Ministrinë e Administratës Publike (MAP). Po ashtu, kemi shikuar nëse pozitat e zyrtarëve dhe koeficientet janë në pajtim me formën e sistemit të payrollit dhe listës së pagave, dhe me këtë rast, nuk kemi vërejtur pa pajtueshmëri ligjore. Megjithatë, testet tona në këtë kategori kanë identifikuar çështjet në vijim:

Çështja 17. Mos respektimi i procedurave të rekrutimit dhe gabime në procesimin e pagesave - Prioritet i lartë

E gjetura Me 01.09.2012 drejtori i arsimit ka nënshkruar kontratë pune me një nëpunës në pozitën zyrtar për infrastrukturë duke anashkaluar të gjitha procedurat e hapura të rekrutimit. Me 29.04.2013 është bërë shpallja e konkursit për këtë pozitë ku është punësuar i njëjti person.

Gjithashtu, me datë 01.08.2013 Kryetari i Komunës ka nënshkruar kontratë me një nëpunës në pozitën zyrtare për buxhet pa procedura të rekrutimit. Pagesa për këtë të punësuar sipas të dhënave nga lista e pagave ka filluar të bëhet nga data 01.05.2013. Një gjë e tillë nuk është në pajtim me rregullën 07/2010 për emërimin e nëpunësve civil.

Me datë 01.02.2013 një nëpunës është caktuar ushtrues detyre në pozitën - shef sektori i gjendjes civile. Sipas ligjit nr. 03/L-149 për shërbimin civil, neni 30 pika 4, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre muaj. Edhe pas skadimit të vendimit deri në fund të vitit pagesa ka vazhduar t'i bëhet me koeficient 7.5 ndërsa sipas aktemërimit pagesa është dashtë që t'i bëhet me koeficient 6.

Në sektorin e arsimit në vitin 2013 janë pensionuar 30 të punësuar. Gjatë rishikimit të vendimeve për pensionim kemi vërejtur që 10 personave nuk iu është bërë ndalesa e pagës sipas datave të pensionimit. Sipas listës së pagave pagesa ju ishte bërë edhe për një muaj shtesë pas shkuarjes në pension.

Gjithashtu në Drejtorinë e arsimit kemi hasur edhe këto parregullsi:

- Një punëtore kishte shkuar në pushim të lehonisë në muajin maj 2013 dhe komuna e kishte paguar me 100% të pagës për 6 mujorin e parë, ndërsa sipas ligjit të punës neni 49 pika 3 pagesa është dashtë të bëhet 70% e pagës bazë;
- Në një rast ndalesa e pagesës për pushim të lehonisë ishte bërë vetëm për 4 muajt e parë të pushimit; dhe
- Ndërsa, në dy raste tjera ndalesa e pagesës ishte aplikuar vetëm për 5 muajt e parë të pushimit të lehonisë.

Rreziku Emërimi i zyrtarëve duke anashkaluar procedurat e hapura të parapara me ligj mund të ndikoj në dëmtimin e konkurrencës. Pagesat e tilla jo korrekte mund të tregojnë që nuk ka kontrolle të mjaftueshme me rastin e procesimit të pagave. Mos përputhjet e lartë përmendura mund të shkaktojnë gabime me rastin e pagesave të tjera, duke qenë në kundërshtim me ligjin e punës dhe ligjin për shërbyesit civil.

Rekomandimi 17 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se janë respektuar të gjitha procedurat e rekrutimit dhe emërimit në përputhje me ligjin për Shërbimin Civil dhe rregulloret në fuqi. Gjithashtu, duhen të vendosen kontrolle të shtuara për të parandaluar gabimet e shumta të identifikuara gjatë procesimit të pagesave. Pagesat e bëra më tepër, duhet t'i kthehen buxhetit të komunës.

4.5.3 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Shpenzimet e planifikuara për subvencione dhe transfere gjatë vitit 2013 kanë qenë 875,880€ ndërsa shpenzimi ishte 787,854€. Për testim kemi marrë gjithsej 21 mostra në vlerë prej 159,501 €, apo rreth 20%.

Çështja 18. Dhënia e subvencionit pa aprovim të Kuvendit Komunal dhe në mungesë të marrëveshjeve - Prioritet i lartë

E gjetura Sipas nenit 7 të Rregullores së brendshme për subvencione të Komunës, subvencionet për persona juridik në vlerë mbi 2,000€ duhet të jepen me vendim të Komitetit për Politikë dhe Financa, me autorizim paraprakë nga Kuvendi Komunal. "KRM UNITETI SHA" ka parashtruar kërkesë për marrje të subvencioneve për shpenzime të derivateve në vlerë prej 50,000€. Kjo kërkesë është aprovuar nga Kryetari i Komunës me datë 01.11.2013, duke qenë në kundërshtim me rregulloren. Gjithashtu, komuna nuk kishte ndonjë marrëveshje të nënshkruar me "KRM UNITETI SHA" lidhur me mënyrën e raportimit për mjetet e dhëna si subvencion. Sipas raporteve të dërguara nga kjo kompani, këto mjete ishin shpenzuar për blerjen e një pajisje për pastrim të rrugëve që është në kundërshtim me kërkesën e aprovuar për shpenzimet e derivateve.

Kryetari i Komunës me datën 31.10.2013 ka vendosur të përkrah klubin e Basketbollit "Trepça" në vlerë prej 24,575€ duke e anashkuar nenin 7 të rregullores për subvencione. Gjithashtu, ky klub nuk kishte dërguar një projekt të qartë dhe me një arsyeshmëri të mjaftueshme të kërkesës, siç definohet me nenin 5 të kësaj rregulloreje.

Me vendim të Kryetarit të Komunës të datës 04.09.2013 është aprovuar kërkesa e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL) si përkrahje financiare për projektin "Ushtrroje të drejtën tënde Voto" në vlerë 1,990€. Kërkesa e bërë nga OJQ nuk i kishte plotësuar kriteret e parapara me nenin 18 pika 7 të rregullores së brendshme për subvencione, si: çertifikata e regjistrimit dhe raporti për gjendjen financiare të OJQ për dy vitet paraprake. PAGESA është bërë me 23.09.2013. Komuna nuk ka lidhur një marrëveshje me KVRL lidhur me mënyrën e raportimit për shërbimet e ofruara.

Rreziku Subvencioni i dhënë prej 50,000€ ishte dhënë për derivate, ndërsa kishte rezultuar me blerjen e pajisjeve, dhe si i tillë është i parregullt. Dhënia e subvencioneve në kundërshtim me rregulloren për subvencione dhe pa ndonjë marrëveshje mirëkuptimi me përfituesit mbi mënyrën e shpenzimit dhe të raportimit, shton rrezikun për shpenzim jo ligjor të fondeve publike.

Rekomandimi 18 Kryetari Komunal duhet të siguroj që të respektohet rregullorja e brendshme e subvencioneve dhe të bëhen marrëveshje me përfituesit duke i obliguar për mënyrën e shpenzimit dhe raportimit në mënyrë që të sigurohet që subvencionet kanë arritur objektivat.

Çështja 19. Subvencionet janë shpenzuar për Investime Kapitale dhe Mallra dhe Shërbime - Prioritet i mesëm

Nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfere, komuna kishte financuar këto projekte: projektin e sanimit të rrugës në relacionin Dedi-Bahtir-Bistricë në vlerë prej 9,970€, Projektin për kryerjen e punëve në rregullimin e rrugës në fshatin Terrsten në vlerë prej 9,562, operatorit ekonomik Eurondërtimi për pastrimin e borës në viset rurale të Shalës i ishte dhënë një subvencion në vlerë prej 6,366€. Pagesa e projekteve kapitale nga kategoria e subvencioneve është në kundërshtim me Rregullën Financiare 01/2013 Shpenzimi i Parave Publike.

Rreziku Pagesat nga kategoria e subvencioneve dhe transfere për investime kapitale dhe mallra dhe shërbime rrisin rrezikun që të mos realizohen qëllimet për te cilat janë planifikuar subvencionet.

Rekomandimi 19 Kryetari i Komunës duhet të siguroj se shpenzimet e planifikuara për subvencione dhe transfere duhet të shpenzohen vetëm në këto fusha, në mënyrë që të arrihen objektivat dhe shpenzimet të behën në pajtim me kërkesat ligjore.

Çështja 20. Dhënia e subvencioneve pa kritere te caktuara- Prioritet i lartë

E gjetura Me vendim të Kryetarit të Komunës të datës 18.06.2013 është vendosur që të subvencionohen 7 familje me material ndërtimor. Nuk janë vendosur kritere paraprake dhe nuk është bërë një thirrje publike për aplikim për këto subvencione që janë paraparë edhe me plan të punës së Drejtorisë për Integritet dhe Mirëqenie Sociale. Nuk ka një raport formal nga ana e ndonjë komisioni për mënyrën e përfitimit të këtyre familjeve. Materiali ndërtimor është dërguar tek përfituesit nga ana e kompanisë kontraktuese pa monitorim nga komuna. Vlera e faturës se paguar ishte 6,538€

Gjithashtu, me vendim të kryetarit të datës 19.07.2013 është vendosur që të përkrahen 250 familje me pako ushqimore në vlerë totale prej 10,000€ nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale. Edhe pse ishte projekt i paraparë, kjo drejtori nuk kishte bërë thirrje publike dhe nuk kishte vendosur kritere të caktuara për përfitimin e këtyre subvencioneve. Përpilimi i listës së përfituesve është bërë pa ndonjë komision formal dhe po ashtu furnizimi është bërë direkt nga kompania kontraktuese DPT Genci dhe nuk ka raport të monitorimit nga komuna.

Ne konkursin e shpallur nga komuna me datë 14.12.2012 për ndarjen e bursave për studentë kishin aplikuar 156 kandidatë, prej te cilëve 50 janë shpallur përfitues. Ne kemi ekzaminuar 10 aplikacione dhe kemi vërejtur që 2 përfitues të bursës nuk i kishin plotësuar kriteret e konkursit. Gjithashtu, komisioni kishte vendosur që të ndaj 16 bursa për studentët më shumë se sa që ishin të paraparë me vendimin e kryetarit.

Rreziku Mos vendosja e kriterëve paraprake për subvencione dhe mos monitorimi nga ana e komunës rrit rrezikun që subvencionet e dhëna të mos shfrytëzohet për qëllimin e dhënë..

Rekomandimi 20 Kryetari i Komunës duhet të siguroj që të vendosen kritere për përfituesin nga një komision i formuar nga komuna, dhe të respektohen kriteret e vendosura.

4.6 Pasuritë dhe detyrimet

4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Komuna ka vazhduar me procesin e regjistrimit të pasurive, dhe krahasuar me vitin paraprak, ne vlerësojmë progresin e arritur nga menaxhmenti për të regjistruar dhe mirëmbajtur pasuritë. Përkundër kësaj, komuna ende nuk ka arritur të ndërtoj regjistra të plotë dhe të besueshëm me të dhënat mbi gjendjen e pasurisë që e posedon.

Në vitin 2012 vlera neto e pasurive në regjistrin kontabël ishte 15,329,000€ ndërsa në vitin 2013-të ishte 24,090,580€.

Çështja 21. Mungesa e regjistrimit të plotë të pasurive dhe mos pajtueshmëri me rregulloren për pasuri - Prioritet i lartë

E gjetura Bazuar në rregulloren nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë ZKA duhet të emëroj një Komision për vlerësimin e pasurive dhe një Komision për inventarizim të pasurisë në baza vjetore. Komuna nuk ka emëruar komision të vlerësimit të pasurisë që nga viti 2008 ndërsa një komision i inventarizimit ishte emëruar me 26.11.2013, mirëpo nuk e kishte përfunduar punën deri me 10.02.2014. Vlera e pasurisë e prezantuar në PVF vjetore nuk është e harmonizuar me raportin e inventarizimit.

Gjatë procesit të rishikimit të pasurive kemi vërejtur që komuna mban regjistra të pasurive kapitale dhe jo kapitale mirëpo këto evidenca nuk ishin plotësuar me pasuritë të cilat janë identifikuar si pronë e komunës. Sipas regjistrave të drejtorisë së urbanizmit janë 49 banesa, 24 lokale afariste dhe 18 parcela tokë të cilat janë pronë e komunës. Këto nuk janë të regjistruara në regjistrat e pasurisë në mungesë të përcaktimit të vlerës së tyre sepse nuk është formuar një komision për vlerësimin e pronës komunale.

Gjatë rishikimit fizik të disa pajisjeve mjekësore me të cilat janë furnizuar drejtoria e shëndetësisë, ne kemi vërejtur që këto pajisje nuk janë identifikuar me barkod-e, siç kërkohet me nenin 6 pika 4 të rregullores për menaxhim të pasurive.

Sipas nenit 4 pika 3 dhe 4, çdo zyrtar i organizatës buxhetore duhet të jetë përgjegjës për pasurinë të cilën e ka në përdorim.

Rreziku Mos regjistrimi i plotë i të gjitha pronave të cilat janë në pronësi të komunës, rritë rrezikun e nënvlerësimit të pasurisë së komunës dhe paraqitjes jo të drejt të vlerës së pasurisë në pasqyrat vjetore financiare. Mos regjistrimi i pasurisë sipas rregullores për menaxhim të pasurisë rrit rrezikun e humbjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të pa autorizuar të tyre.

Rekomandimi 21 Kryetari i Komunës duhet të siguroj formimin e një komisioni profesional për pasuri dhe ato të regjistrohen në regjistrat e pasurisë.

Çështja 22. Regjistrimi i jo i saktë i pasurisë - Prioritet i mesëm

Kemi vërejtur se komuna kishte regjistruar gabimisht si pasuri të vetën shpenzimet e bëra për pastrimin e lumenjve dhe subvencionimin e Bashkësinë Islame për shërbime të varrimit në vlerë 100,250€.

Rreziku Regjistrimi i gabuar i pagesave të cilat nuk i përmbushin kushtet për tu regjistruar si pasuri kapitale ndikon në mbivlerësimin e pasurisë së komunës.

Rekomandimi 22 Kryetari i Komunës duhet të siguroj që të ketë nivele me të larta të kontrollit lidhur me regjistrimin e pasurisë në SIMFK. Ky regjistër duhet që të rishikohet dhe të korrigjohet.

4.6.2 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Pasqyra e obligimeve të pakryera ndaj furnitorëve në fund të vitit 2013 ishte 972,000€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2013.

Çështja 23. Hyrje në obligime më shumë se sa buxheti i aprovuar - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna kishte hyrë në obligime më shumë se ndarjet buxhetore. Fondi i ndarë për kategorinë mallra dhe shërbime për vitin 2013 ishte 1,488,085€, ndërsa ishin shpenzuar 1,380,403€ apo 93%, ndërsa obligimet e papaguara për këtë kategori ishin 441,000€. Gjithashtu edhe shpenzimet komunale ishin shpenzuar 425,405€ apo 99%, derisa obligimi i papaguar për këtë kategori ishte 17,000€. Këto shifra pasqyrojnë faturat e pranuar të cilat nuk janë paguar. Kjo gjendje tregon se komuna nuk i kishte menaxhuar drejt obligimet e papaguara.

Rreziku Kjo rrit rrezikun se planet e ardhshme të shpenzimeve nuk mund të arrihen për shkak të nevojës për të paguar obligimet e viteve paraprake. Hyrja në obligime me shumë se sa ndarjet buxhetore mund ta sjellë komunën në vështirësi financiare, me mundësinë që të njëjtat të shndërrohen në konteste gjyqësore.

Rekomandimi 23 Kryetari i Komunës duhet të harmonizoj ndarjet buxhetore me hyrjen në obligime dhe të sigurohet se të gjitha obligimet mbahen nën kontroll dhe shoqërohen me fondet përkatëse buxhetore.

4.7 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Njësia e auditimit të brendshëm ka bërë një punë të mirë duke kryer raporte në fusha të ndryshme për ti ndihmuar menaxhmentit të lartë që ta ketë një pasqyrë rreth funksionimit të kontrolleve dhe aktiviteteve në komunë.

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij ne e prezantojmë këtu ndaras. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit.

NJAB-i për vitin 2013 kishte planifikuar të kryej gjashtë auditime sipas planit dhe kishte arritur që ta realizoj planin në tërësi, dhe një raport me kërkesë të kryetarit. Auditimet kishin mbuluar aktivitetet që kanë qenë në proces dhe për vitin aktual.

Raportet e NJAB-it kanë qenë të një cilësie të mirë ku kanë përmbajtur të gjetura dhe rekomandime të qarta.

Komiteti i Auditimit kishte mbajtur katër takime, ku është diskutuar për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga ZAP dhe NJAB. Menaxhmenti nuk i ka adresuar plotësisht rekomandimet e dhëna.

Po ashtu, NJAB-i kishte përgatitë raporte tre mujore, të cilat i kishte dërguar edhe në Njësinë Qendrore Harmonizuese në MF.

Çështja 24. Adresimi i rekomandimeve nga NJAB-i - Prioritet i lartë

E gjetura Ne kemi vërejtur se menaxhmenti nuk është marrë seriozisht me adresimin e të gjitha rekomandimeve të dhëna nga NJAB-i.

Rreziku Mungesa e angazhimit nga menaxhmenti për adresimin rekomandimeve të dala nga NJAB rritë rrezikun se këto rekomandime të mos adresohen dhe dobësitë të përsëriten.

Rekomandimi 24 Kryetari i Komunës duhet të diskutoj me auditimin e brendshëm mbi mangësitë e kontrolleve dhe rëndësinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga NJAB, dhe në bazë të kësaj, të nxjerrë një Plan veprimi duke urdhëruar Drejtoritë përkatëse zbatimin e rekomandimeve të dala nga auditimi i brendshëm.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar nëse** arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornizë për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk përhapen në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë materiale por nuk përhapen.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe përhapen në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë edhe materiale edhe të përhapen. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705¹⁹ jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
2.1 Prezantimi i Pasqyrat Financiare	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që PVF për 2013 formalisht adresojnë të gjitha kërkesat e pajtueshmërisë dhe përfshin rishikimin e rekomandimeve të bëra nga ZAP në vitin 2012.			JO
2.2 Procesi i Hartimit të Pasqyrat Financiare	Kryetari i Komunës duhet të siguroj vlerësimin e stoqeve dhe ti përfshijë ato në kuadër të shpalosjeve të PVF-ve.	PO		
2.3 Procesi i Përgatitjes së PVF-ve	Kryetari i Komunës duhet të siguroj që në të ardhmen e afërt të formoj një komision i cili do të bënte vlerësimin e drejtë dhe të plotë të të gjithë pasurisë fikse që është në pronësi të Komunës.			JO
3. Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i veprimtimit i rishikuar në mënyrë të qartë përcakton një afat kohor për adresimin rekomandimeve me anëtarët e stafit llogaridhënës, të identifikuar - me fokus fillestar në ato të një rëndësie të madhe.		Pjesërisht është adresuar	
4.2 Te hyrat nga bizneset lokale	Kryetari i Komunës duhet të bëj një kontroll rigoroz për të identifikuar bizneset aktive në			JO

	kuadër të Komunës para faturimit të ardhshëm të taksave të biznesit.			
4.2.1 Të hyrat e planifikuara	Kryetari i Komunës duhet të kërkoj që bëhet një analizë e detajuar e të hyrave për vitin 2012 për të siguruar plotësinë e pranimeve dhe për të siguruar që një proces i fuqishëm është funksional për të përcaktuar rrjedhat e mundshme të të hyrave në vitet e ardhshme.			JO
4.2.2 Të hyrat-mangësitë e Sowntverit	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se një sistem i duhur i regjistrimit vihet në funksion për të mbështetur inkasimin dhe regjistrimin e të hyrave.	PO		
4.2.3 Mos barazimet e të hyrave	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që duhet të bëhen barazimet e rregullta në mes të departamentit për gjenerimin e të hyrave dhe Thesarit.	PO		
4.2.4 Ndërtimet pa leje	Kryetari i Komunës duhet të rishikojë sistemet ekzistuese për të kontrolluar projektet e ndërtimit, të vlerësojë efektivitetin e tyre përfshirë edhe mbështetjen e dhënë ligjore dhe zbatimin e përmirësimeve të kërkuara.			JO
4.2.5 Objektet e dhënë me qira	Kryetari i Komunës duhet të zbatoj një proces regjistrimi të të gjitha pronave dhe ngarkesave shoqëruese, i cili do të shqyrtohej të paktën çdo gjashtë muaj nga një zyrtar i lartë.			JO

4.5 Shpenzimet	Kryetari i Komunës duhet të përcaktoj pse nuk janë ndjekur procese të efektshme të prokurimit në këtë rast dhe të sigurojë që kontrollet ekzistojnë apo janë në funksion për të siguruar se procedurat e prokurimit janë aplikuar. Kriteret duhet të jenë të vendosur në kontekstin e asaj që konsiderohet si 'specifikacion' i arsyeshëm për blerjet specifike.			JO
4.5.1 Mëditjet jashtë vendit	Kryetari i Komunës duhet që t'i lejoj udhëtimet jashtë vendit, vetëm nëse më parë është siguruar se ka fonde të mjaftueshme, si dhe të forcoj kontrollet dhe disiplinën financiare.	PO		
4.5.2 Mungesa e komisionit për pranimin e shërbimeve	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë kryerjen e kontroleve për të siguruar që baza për të gjitha pagesat e bëra në lidhje me kontratat. shërbime të mbështetet nga dokumentacioni i duhur.	PO		
4.5.3 Kompensimet	Kryetari i Komunës duhet të zgjidhë këtë jokonsistencë, dhe të përcaktoj nëse ky është vetëm një rast i izoluar apo një dukuri e përhapur. Varësisht nga rezultati i kësaj, duhet të vendosen kontrole të shtuara për të parandaluar gabimet e tilla të pagesave.			JO
4.5.3.1 Emërimi i stafit pa konkurs	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që rregullat dhe kërkesat e Ligjit mbi Shërbimin Civil janë			JO

publik	aplikuar në të gjitha procedurat e rekrutimit.			
4.5.4 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari i Komunës duhet formalisht të miratojë një rregullore që do të specifikojë kriteret dhe shpenzimet e subvencioneve. Shpenzimet e planifikuara për kategorinë e subvencioneve dhe transfereve duhet të shpenzohen vetëm në këto fusha.		Pjesërisht është adresuar	
4.5.4.1 Dhënia e bursave jo sipas kritereve	Kryetari i Komunës duhet të zbatojë një proces për të siguruar që komisioni i cili vlerëson aplikacionet nxjerr vendime transparente/të drejta dhe të paanshme.			JO
4.6.2 Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të hartoj një plan për inaksimin e te hyrave.		Pjesërisht është adresuar	
4.7 Trajtimi i borxheve	Të gjitha zotimet duhet të monitorohen nga Kryetari i Komunës për të siguruar se zotimet të mos i tejkalojnë ndarjet e përgjithshme buxhetore.			JO
5 Auditimi i brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të nxjerr një plan veprimi, i cili duhet të zbatohet, për të adresuar rekomandimet e NJAB duke specifikuar zyrtarët përgjegjës dhe kohën për kryerjen e veprimeve.		Pjesërisht është adresuar	